



Miratuar dhe nënshkruar më  
23 shtator 2005  
Shqip

Takim i Nivelit të Lartë i Ministrave të Brendshëm  
dhe Sigurisë si dhe Zyrtarëve të Lartë të Qeverive  
dhe Administratave nga Europa Jug-Lindore

mbi Strategjinë Rajonale për Instrumentet kundër  
Krimin të Organizuar dhe Ekonomik

## **DEKLARATË E PËRBASHKËT**

23 Shtator 2005  
Ishulli i Brijunit, Kroaci

***Ne, Ministrat e Brendshëm, Ministrat e Sigurisë dhe Zyrtarët e Lartë të Qeverive dhe Administratave nga Europa Juglindore***

Duke marrë pjesë në këtë Takim të Nivelit të Lartë të Ministrave të Brendshëm, të Sigurisë dhe të Zyrtarëve të Lartë mbi Strategjinë Rajonale për Instrumentet kundër Krimit të Organizuar dhe Ekonomik mbajtur në ishullin e Brijunit (23 Shtator 2005);

Në bashkëpunim me Këshillin e Evropës, Komisionin Evropian dhe organizata të tjera ndërkombëtare

***Në kapacitetin tonë zyrtar***

*Duke rikujtuar* objektivat, standardet dhe detyrimet që rrjedhin nga standardet evropiane dhe standardet e tjera ndërkombëtare kundër krimit ekonomik, pastrimit të parasë, korrupsionit, trafikimit të qenieve njerëzore, transportimit të klandestinëve dhe formave të tjera të krimit të organizuar dhe ekonomik;

*Duke pranuar* zhvillimin e arritur nga vendet dhe administratat tona në rregullimin e legjislacionit penal si dhe në ngritjen dhe forcimin e kapaciteteve të shërbimeve të specializuara të drejtësisë penale për luftimin e krimit ekonomik, pastrimit të parasë, korrupsionit, trafikimit të qenieve njerëzore, transportimit të klandestinëve dhe formave të tjera të krimit të organizuar dhe ekonomik;

*Duke njohur* nevojën e menjëhershme për të përmirësuar më tej kuadrin tonë ligjor dhe institucional dhe për të shtuar kapacitetet tona për një zbatim më efektiv të legjislacionit;

*Duke pranuar* ngjashmëritë dhe ndryshimet si dhe karakterin rajonal të sfidave me të cilat ne përballemi ndërkohë që besojmë se një luftë e efektshme kundër krimeve të rënda kërkon një bashkëpunim rajonal dhe ndërkombëtar më të madh dhe më funksional;

*Duke u bazuar* në Deklaratën e Londrës të Nëntorit 2002, në Procesin e Stabilizim Asociimit, si dhe në të tjera angazhime, përpjekje, mësim të nxjerra dhe eksperiencat të dala prej tyre;

*Duke riafirmuar* detyrimin tonë për të respektuar, në përpjekjet tona për të luftuar krimet e rënda, instrumentat ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe në veçanti Konventën për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Themelore dhe jurisprudencën e Gjykatës Evropiane e të Drejtave të Njeriut;

*Duke mbështetur* konkluzionet e Grupeve të Punës dhe ekspertëve në kuadër të projektit të përbashkët CARPO të Këshillit të Evropës dhe Komisionit Evropian;

*Duke besuar* se politikat publike të kombinuara me veprimet kundër krimeve të rënda duhet të mbështeten në njohuri dhe duhet të burojnë nga informacionet që mblidhen nëpërmjet një sistemi të strukturuar për mbledhjen,

analizimin dhe përpunimin sistematik të të dhënave në përputhje me standartet Evropiane për mbrojtjen e të dhënave personale;

*Duke rënë dakord se goditja e produkteve të krimit, ne luftimin e krimeve të rënda nëpërmjet hetimeve financiare që çojnë në identifikimin, sekuestrimin dhe konfiskimin e të ardhurave të krimit, është një pjesë e rëndësishme e çdo strategjie kundër krimeve të rënda;*

*Duke pranuar që nëse duam ta pengojmë krimin në të gjitha format dhe variacionet e tij moderne, organet e zbatimit të ligjit, duhet të vënë në përdorim mjete të efektshme dhe strategji moderne policore në procesin e zbulimit, hetimit dhe gjykimin, duke përfshirë dhe mjetet e posaçme të hetimit, nëpërmjet një kuadri ligjor të konsoliduar dhe nje strukture të përshtatshme institucionale me mekanizma kontrolli dhe mbikqyrje gjyqësore efektive;*

*Duke qënë të vetëdijshëm se një sistem i posaçëm masash, që sigurojnë mbrojtjen efektive të dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë përpara, gjatë dhe mbas proceseve penale, përbën një mjet thelbësor për hetimin dhe gjykimin e suksesëshëm të krimeve të rënda, si dhe një detyrim të sistemit të drejtësisë penale ndaj dëshmitarëve dhe viktimave të krimit;*

*Duke besuar se krimet e rënda ndër-kufitare përbëjnë një sfidë të cilën vendet nuk mund ta përballojnë dot vetëm dhe se bashkëpunimi ndërkombëtar dhe reciprok në çështjet penale luan një rol kyç në kuadrin e përgjithshëm të marrdhënieve midis Shteteve dhe juridiksioneve si në nivel evropian ashtu dhe në atë ndërkombëtar në lidhje me këtë çështje.*

### **Ne vendosim**

## **STRATEGJINË RAJONALE PËR MJETET KUNDËR KRIMIT TË ORGANIZUAR DHE EKONOMIK paraqitur në këtë takim**

**dhe**

**angazhohemi:**

Në përputhje më qëllimet dhe masat e vendosura në Strategji,

- për të përmirësuar kuadrin tonë ligjor dhe kapacitetet institucionale në fushën e analizimit të krimit dhe sistemin e informimit mbi krimin;
- për të nxitur miratimin dhe zbatimin, në sistemet tona të drejtësisë penale dhe të zbatimit të ligjit, të konceptit të hetimit të ndërlidhur financiar dhe penal me qëllim konfiskimin e produkteve të krimit,
- për të vazhduar ngritjen e kapaciteteve në përdorimin e mjeteve të posaçme të hetimit për zbulimin dhe hetimin e veprave të rënda penale, ndërkohë që përdorimi i këtyre mjeteve i nënshtrohet parimeve strikte të ligjshmërisë, proporcionalitetit, mbrojtjes procedurale dhe mekanizmave mbikëqyrës,

- për të vazhduar përpjekjet tona në ngritjen e një sistemi të konsoliduar për mbrojtjen e dëshmitarëve, viktimave në rrezik dhe bashkëpunorëve të drejtësisë përpara, gjatë dhe pas procedurave penale,
- për të forcuar kapacitetet tona në dobi të një sistemi funksional të bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar për çështjet penale;

Të sigurojme bashkëpunim rajonal dy-palësh dhe shumë-palësh dhe zbatimin e mësimave të nxjerra nga rajoni gjatë zbatimit të Strategjisë, duke shtuar në njëjtën kohë përpjekjet për të hartuar zgjidhje të përshtatshme ndaj specifikave të problemeve lokale;

Të nxitim dhënien e mëtejshme të fondeve buxhetore për të siguruar vazhdimin dhe zbatimin e efektshëm të objektivave të Strategjisë;

Të vazhdojmë përpjekjet tona për të mbështetur dhe për të marrë pjesë në projekte që kanë për qëllim zbatimin e objektivave të Strategjisë në një mënyrë të vazhdueshme;

Të rishikojmë në mënyrë të vazhdueshme progresin e arritur dhe për këtë qëllim të mbledhemi përsëri në Shtator 2006 në Sarajevë.

Ishulli i Brijunit, 23 shtator 2005

*Z Sokol OLLDASHI*  
*Ministër i Brendshëm*

*Z. Barisa ČOLAK*  
*Ministër i Sigurisë*

*Z. Ivica KIRIN*  
*Ministër i Brendshëm*

*Z. Ljubomir MIHAJLOVSKI*  
*Ministër i Brendshëm*

*Z. Dragan DJUROVIĆ*  
*Zëvendës Krye Ministër*  
*Ministër i Brendshëm*

*Z Dragan JOČIĆ*  
*Ministër i Brendshëm*

*Z Jean DUSSOURD*  
*Zëvendës Përfaqësues i Posaçëm*  
*i Sekretarit të Përgjithshëm*  
*Për Policinë dhe Drejtësinë*  
*UNMIK*